BULETIN I LAJMEVE TË SIGURISË KIBERNETIKE

Janar 2024

Përmbajtja:

- Rëndësia e Mbrojtjes së të Dhënave dhe Akreditimit me ISO 27701 në Shqipëri
- Inaugurimi i Njësisë Ushtarake të Sigurisë Kibernetike

Rëndësia e Mbrojtjes së të Dhënave dhe Akreditimit me ISO 27701 në Shqipëri

Shqipëria bën një hap më tej drejt forcimit të infrastrukturës së saj të sigurisë së informacionit me rritjen e ndërgjegjësimit dhe promovimin e certifikimit me ISO 27701, duke bërë bashkë në një takim gjithë aktorët përkatës. AKCESK si një kontributor i rëndësishëm i këtij procesi, mori pjesë në një nga panelet e takimit të organizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, mbështetur nga RisiAlbania, një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim dhe i zbatuar nga Helvetas Albania.

ISO 27701 është një standard i privatësisë së të dhënave që bazohet në ISO 27001, standardi ndërkombëtar më i përdorur për menaxhimin e sigurisë së informacionit. Certifikimi dhe Standardet, përveçse një kërkesë e BE-së, krijojnë mundësi për rritje, shërbime outsource apo eksporte – procese që do të krijojnë vende pune për të rinjtë shqiptarë.

Ky aktivitet erdhi si një përpjekje e përbashkët për të nxitur një mjedis më të sigurt dhe më të favorshëm për të gjithë palët e interesuara në ekosistem. Përdorimi i Standarteve ISO 27701 ndikon drejtëpërdrejtë në zhvillimin e biznesit me standarte ndërkombëtare, duke nxitur rritjen e sigurisë së informacionit dhe konkurueshmerine e biznesit në tregun vendas dhe të huaj dhe duke i afruar kompanitë tona me tregun Europian.

Gjatë takimit u zhvilluan diskutime me ekspertë, të cilët përfaqësonin aktorë të rëndësishëm në tregun shqiptar. Panelistët, përfshirë Blerina Qazimin, Besa Stringën, Sokol Avxhiun, Saimir Kapllani, Alfons Muça, Nikolin Metaj dhe Raffaelle Regni, ndanë njohuritë e tyre për temat kritike si nevoja për certifikime të akredituara për standardet 27701, 27017 dhe 2701.

Inaugurimi i Njësisë Ushtarake të Sigurisë Kibernetike

Një lajm i shumë i mirë në sferën e mbrojtjes kibernetike për Shqipërinë është hapja e Qendrës së Reagimit ndaj Sulmeve Kibernetike(CCARC) pranë Ministrisë së Mbrojtjes. Kjo qëndër u bë e mundur me mbështetjen e qeverisë amerikane dhe tregon se hedhim një hap më tej në thellimin e partneritetit strategjik, duke thelluar bashkëpunimin në rritjen e sigurisë në sistemet e informacionit.

Qendra e re do luaj një rol kyç në reagimin ndaj sulmeve kibernetike kundër infrastrukturës së teknologjisë së informacionit në fushën e mbrojtjes dhe do i shërbejë rritjes së nivelit të sigurisë kibernetike në vend.
AKCESK, si Autoritet përgjegjës për infrastrukturat civile të informacionit, është ne bashkëpunim të vazhdueshëm me Ministrinë e Mbrojtjes në kuadër të rritjes së nivelit të sigurisë kibernetike në Shqipëri.

Rruga "Papa Gjon Pali II", No.3
info@cesk.gov.al
Autoriteti Kombëtar për CESK
autoriteti_kombetar_cesk
+35542221039

BULETINI I LAJMEVE TË SIGURISË KIBERNETIKE

Janar 2024

Përmbajtja:

AKCESK në takim me Institucionet Financiare

Ngjarjet kibernetike në të cilat po kalon Shqipëria së fundmi, mblodhën në një tryezë diskutimesh ditën e djeshme, datë 23 janar, AKCESK dhe drejtuesit e lartë të institucioneve të sektorit financiar.

Në takim, Koordinatori Kombëtar për Sigurinë Kibernetike, z. Igli Tafa, theksoi rëndësinë e rolit të investimeve në këtë sektor të infrastrukturave kritike për rritjen e sigurisë kibernetike. Të pranishmit u njohën me domosdoshmërinë e forcimit dhe mbrojtjes kibernetike të institucioneve duke u fokusuar në disa hapa:

Investime në Teknologji - nevoja për përdorimin e teknologjive të fundit të mbrojtjeës kibernetike për të mbrojtur informacionin dhe të dhënat e klientëve.

Masat Operacionale - ngritja e standarteve të sigurisë së përditshme të institucionit nga ana operacionale dhe administrative sipas referencave NIST ose ISO 27001.

Niveli Menaxherial - roli i lidership-it në detyrimin e institucionit për të investuar në ngritjen e ndërgjegjësimin e stafit në kuadër të sigurisë kibernetike, në përcaktimin e buxhetit në fushën e sigurisë kibernetike si edhe në përcaktimin e rrezikut kibernetik në mënyrë të vazhdueshme.
Rritja e Kapaciteteve - Investim në rritjen profesionale të eksperteve dhe mbulimin e vakancave të evidentuara në fushën e sigurisë kibernetike.

Në takim u theksua nevoja e rritjes së bashkëpunimit mes AKCESK dhe sektorit financiar për të ndarë sa më shumë informacion dhe për të ndërmarrë masat e duhura, në kohën e duhur, që sigurojnë një ekosistem të sigurtë kibernetik. Aty u theksua dhe nevoja për një qasje të vazhdueshme dhe aktive, në bashkëpunim konkret, për të adresuar sfidat kibernetike në të ardhmen.
AKCESK kërkoi që sektori financiar të bashkërendojë punën me veprime konkrete për implementimin e masave të shtuara të sigurisë për vitin 2024.

HPE - data breach

Sulmuesit Kibernetik të njohur si APT29 dyshohet se kanë infiltruar në platformat cloud të kompanisë së teknologjisë së informacionit Hewlett Packard Enterprise (HPE) për të shfrytëzuar të dhënat në mailbox.

Aktori i kërcënimit aksesoi dhe nxorri të dhëna duke filluar nga maji i vitit 2023 nga një përqindje e vogël e malibox-eve që u përkasin individëve në sigurinë kibernetike, bizneseve etj.
HPE, megjithatë, theksoi se incidenti nuk ka pasur ndonjë ndikim material në operacionet e saj deri më sot.

Link: Lexo më shumë

PATCHING ALERT



GitLab - patching alert

GitLab ka publikuar së fundmi përditësime sigurie për të adresuar dy vulnerabilitete kritike.
Një nga vulnerabilitetet kritike është si rezultat i një gabimi në procesin e verifikimit të emailit, i cili lejon përdoruesit të rivendosin fjalëkalimin e tyre përmes një adrese emaili dytësor.

Për të zbutur çdo kërcënim të mundshëm, këshillohet që të përmirësoni instancat në një version të *patchuar* sa më shpejt të jetë e mundur dhe të aktivizoni 2FA, veçanërisht për përdoruesit me privilegje të larta.

Link:Lexo më shumë

Rruga "Papa Gjon Pali II", No.3
info@cesk.gov.al
Autoriteti Kombëtar për CESK
autoriteti_kombetar_cesk
+35542221039